



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LUSHNJË  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lushnjë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “ *Sistemim, asfaltim i rrugës Golem i Madh- Golem i Vogël  
L=2680 ml* ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 –  
Punë ndërtimi**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 70 434 873,33 (shtatëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e  
katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) LEKË pa TVSH dhe 84  
521 848 ( tetëdhjetë e katër milion e pesëqind e njëzet e një mijë e tetëqind e dyzet e  
tetë) LEKË me TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Lushnjë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas Shtojcës 7 të DST**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se : 70 434 873,33 (shtatëdhjetë milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre presje tridhjetë e tre) LEKË pa TVSH (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

**2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare **2024, 2025**, të konfirmuara nga organet tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e këkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin e fundit (këstet e maturuara)** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për **vitin e fundit (këstet e maturuara)**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe

neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

Meqënëse operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

### **2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **35 217 436,67 (tridhjetë e pesë milion e dyqind e shtatëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH**, (50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,  
ose,
- b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se **140 869 746,66 (njëqind e dyzet milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH** (dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet)

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
  - Kontratë Sipërmarrje
  - Situacionin përfundimtar;
  - Aktin e kolaudimit;
  - Certifikaten e marrjes ne dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
  - Kontrate Sipërmarrje;

- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Certifikaten e marrjes ne dorezim/ Certifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
- Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

*pika 2.3.1* duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

***Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:***

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

**2.4 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore:**

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Licensë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **N.P. 4 C** (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- **N.S. 6 A** (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)

- **N.S. 18 A** (Punime topogjeodezike)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, nr.42, datë 16.01.2008 i ndryshuar). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" i ndryshuar, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 8 ku përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

**Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:**

**N.P. 4 C** (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)

Për punime në rrugë dhe sheshe pavarësisht nga shkalla e tyre e vështirësisë. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit në zërat:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSIA	SASIA
		<b>1. ANALIZA TEKNIKE</b>		
1	3.226/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	11650
		<b>SHUMA 1:</b>		
		<b>2. PUNIME SHITESASH</b>		

2	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m2	9370
3	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	950
4	3.212/d	Shtrese stabilizant t=20cm	m2	2410
		<b>SHUMA 2:</b>		
		<b>3. PUNIME GERMIMI</b>		
5	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	1650
6	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	10
		<b>SHUMA 3:</b>		
		<b>4. PUNIME DHEU</b>		
7	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	1650
8	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	160
9	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	10
		<b>SHUMA 4:</b>		
		<b>5. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE</b>		
10	3.558	Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)	copë	8
		<b>SHUMA 5:</b>		
		<b>6. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESH. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE</b>		
11	3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	5360
12	3.949	Vizime me boje bikomponente	m2	50
13	3.955	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	25
		<b>SHUMA 6:</b>		
		<b>7. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA</b>		
14	3.172	F.V. Kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement	copë	1
15	3.169	F.V. Shtylla metalike per ndriçim, H=7m, d=160mm	copë	79
16	3.168	F.V. Krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	copë	79
17	3.182	F.V. Elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	copë	81
18	3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	79
19	3.164/1t	F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	70

		<b>SHUMA 7:</b>		
		<b>8. INSTALIME PER NDRICIM</b>		
20	2.500	F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur	ml	162
		<b>SHUMA 8:</b>		
		<b>9. PUNIME TE NDRYSHME</b>		
21	3.654/1	F.V. Tuba plastmasi ø 80	m	2700
22	3.616/a	F.V. Bordura betoni 15x25cm	m	1500
		<b>SHUMA 9:</b>		
		<b>10. GAZ E NAFTESJELLES</b>		
23	4.131/3.5	F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar, 4x10mm2	m	1000
		<b>SHUMA 10:</b>		
		<b>11. PUNIME SHTRESASH 2</b>		
24	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	295
25	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	22
26	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	180
27	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	10
		<b>SHUMA 11:</b>		
		<b>12. NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b>		
28	2.288	Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit	m2	1802
		<b>SHUMA 12:</b>		
		<b>13. PRISHJE</b>		
29	2.426/2	Prishje mur blloqe betoni	m3	160
		<b>SHUMA 13:</b>		
		<b>14. PUNIME BETONI DHE B/A</b>		
30	2.112	Mure buto betoni C 12/15	m3	145
31	2.112	Mure buto betoni C 12/15	m3	105
		<b>SHUMA 14:</b>		
		<b>15. PUNIME MURATURE TULLE</b>		
32	2.64/2	Mur me tulla te plota zak, deri 3m, llaç perzier M 25	m3	160
		<b>SHUMA 15:</b>		
		<b>16. PUNIME BETONI E BETONARMEJE</b>		
33	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20	m3	23
		<b>SHUMA 16:</b>		
		<b>17. PUNIME HEKUR BETONI</b>		
34	2.166	F.V. Hekur betoni periodik ø 6 - 10 mm	ton	2.2
		<b>SHUMA 17:</b>		
		<b>18. PUNIME ASFALTIMI</b>		

35	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri	m2	11650
<b>SHUMA 18:</b>				
<b>19. UJESJELLES E KANALIZIM I JASHEM</b>				
36	2.336	Pusetë shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm	copë	6
<b>SHUMA 19:</b>				
<b>20. ANALIZA JASHE LISTE</b>				
37	An	F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesë plastmasi, te armuar, 4x6mm <sup>2</sup>	m	850
38	An	F.V. Ne toke kablllo Cu fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesë plastmasi, te armuar, 4x4mm <sup>2</sup>	m	850
39	An	F.V Ndricues Led 100 W	copë	79
40	An	F.V. tuba plastmasi Ø 40	m	83
41	An	F.V Percjelles elektrik FS -17 3X2.5 mm <sup>2</sup>	ml	553
42	An	F.V. Rrethim me rrjete çelik i zinkuar + PVC 4 mm h= 1 m	ml	560

#### **N.S. 6 A** (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)

Për punime të sinjalistikës vertikale dhe horizontale. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit në zërat:

<b>6. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESI. NGADALESUESIT E SHPEJTËSISE</b>				
11	3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjerësi 15 cm	ml	5360
12	3.949	Vizime me boje bikomponente	m <sup>2</sup>	50
13	3.955	F.V. Tabela te ndryshme rrugore D=60cm	copë	25

#### **N.S. 18 A** (Punime topogjeodezike)

Për punime topogjeodezike të nevojshme gjatë kryerjes së punimeve në të gjitha proceset. Për këtë gjë është kërkuar ky zë licence.

**2.4.1** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Topograf
- 2 (dy) Elektriçist

## Per te vertetuar personelin duhet:

- Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, deshmi profesionale ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune, diplomat ose kualifikimet per punonjës të specializuar/të kualifikuar

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafit teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi - Për njohjen me projektin dhe zbatimin në kohë e në cilësi të tij. Organizimin e rradhës së punimeve sipas preventivit dhe grafikut të punimeve. Mbajtjen e proces verbaleve dhe akt-kontrolleve për çdo fazë të projektit. Hartimin e librezës së masave, ditarin e punimeve, situacioneve pjesore dhe përfundimtar
- 1 (një) Inxhinier Elektrik- Për interpretimin e projektit dhe për udhëheqjen e punëtorëve në zbatimin e tij për punimet elektrike të paraqitura në preventiv dhe grafikun e punimeve.
- 1 (një) Teknik Ndertimi - Për zbatimin e punimeve që janë parashikuar të kryhen. Koordinimin e punimeve për zbatimin e tyre në kohë si dhe në cilësi. Zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike, të furnizimit dhe të marrëdhënieve të grupeve të ndryshme të punës për respektimin korrekt të preventivit dhe grafikut të punimeve.
- 1 (një) Topograf - Për zbatimin e projektit duke iu referuar kuotave të projektit. Në preventive kemi zera për sistemimin e territorit dhe gjithashtu dhe punimet e drenazhit. për vendosjen e kuotave sipas projektit dhe për një rrjedhshmëri të ujërave kërkohet topografi të vendosi kuota sa më të sakta.
- 2 (dy) Elektriçist - Për zbatimin e projektit elektrik që do të kryhet në objekt kërkohen elektriçistë për zbatimin e tij në afat dhe në cilësi.

**2.4.2** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndertimi dhe të deklarojë se

ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998, i ndryshuar.

**2.4.3** Një punësim mesatar i të paktën **19 (nëntëmbëdhjetë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e fundit të deklaruar.

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

*Numri i punonjesve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjesve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjesve. Vendosija e kriterit për një punësim të **19***

**(nëntëmbëdhjetë)** personave duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018).

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:**

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit **ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- c) Certifikatën e sistemit të menaxhimit të trafikut rrugor **ISO 39001 -2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të

*lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023** është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

**ISO 39001:2012** është standard ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). Njësia e Prokurimit gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (ndërtim rruge) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

**2.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentet e tenderit për **235 (dyqind e tridhjetë e pesë) ditë kalendarike**.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

**2.7.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qira
Rrul kompresor me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qira

Kamionë vetëshkarkues min. 5 ton	3 copë	Pronësi ose me qira
Makineri për skarifikim shtresash rrugore	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qira
Ekskavator 2m <sup>3</sup>	1 copë	Pronësi ose me qira
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qira
Ekskavator me goma 0.25 m <sup>3</sup>	2 copë	Pronësi ose me qira
Autovinç deri 2.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Spërkatës Boje për vijëzime në rrugë	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qira
Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qira
Kallëpe	min 70 m <sup>2</sup>	Pronësi ose me qira
Betoniere min. 0.5 m <sup>3</sup>	1 copë	Pronësi ose me qira
Fabrikë Asfaltbetoni	1 copë	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi
Fabrikë betoni	1 copë	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi
Kamioncinë deri në 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
Instrument për punimet gjeodezike	1 copë	Pronësi ose me qira

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit, më konkretisht: -leja e qarkullimit; certifikatën e pronësisë; -certifikatën e kontrollit teknik; policën e sigurimit (siguracionin) e vlefshme; Certifikatën e transportit të vlefshme; taksat vjetore dhe fotot përkatëse në secilën anë të mjetit/pajisjes, ku në rastet e mjeteve të treguara në foto duhet të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;
- (b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave të cilat duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e punimeve, deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Për fabrikën e betonit dhe fabrikën e asfaltbetonit duhet të paraqitet dokumenti që verteton pronësinë, kontrata e marrjes me qira ose aktmarrëveshjen për furnizim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Arsyetimi teknik për disponimin e mjeteve :

### **Autobitumatrice (copë 1)**

Duhet për shpërndarjen e emulsionit të bitumit gjatë procesit të asfaltimit

### **Asfaltoshtruese (copë 1)**

Për hedhjen ,përhapjen shtrimin e shtresës së binderit dhe asfaltobetonit. Në preventiv kemi shtresë binderi 5 cm 11650 m<sup>2</sup>, shtresë asfaltobetonit 4 cm 11650m<sup>2</sup>

### **Rrul kompresor me vibrim (copë 1)**

Mjet që përdoret për njëtrajtësimin e shtresave të rrugës.

Në preventiv kemi shtresë binderi 5 cm 11650 m<sup>2</sup>, shtresë asfaltobetonit 4 cm 11650 m<sup>2</sup>, mbushje me çakëll e gur gurore 950 m<sup>3</sup>, Në preventiv janë shtresa stabilizanti t = 20 cm: 2410 m<sup>2</sup>,

### **Kamionë vetëshkarkues min. 5 ton (copë 3)**

Këto mjete do të përdoren për largimin e materialit të gërmuar dhe sjelljen e materialeve të kërkuara të objektit. Në preventiv kemi shtresë binderi 5 cm 11650 m<sup>2</sup>, shtresë asfaltobetonit 4 cm 11650 m<sup>2</sup>, mbushje me çakëll e gur gurore 950 m<sup>3</sup>, Në preventiv janë shtresa stabilizanti t = 20 cm: 2410 m<sup>2</sup>, transport materiale ndërtimi dheu: 1820 m<sup>3</sup>, nënshtrësë zhavori 180 m<sup>3</sup>, trotuar me pllaka 1802 m<sup>2</sup>, bordura betony 1500 ml,

### **Makineri për skarifikim shtresash rrugore (copë 1)**

Duhet për skarifikimin e asfaltit ekzistues. Në preventiv kemi 9370 m<sup>2</sup> skarifikim shtrese asfalti ekzistues.

### **Autobot uji (copë 1)**

Për sjelljen e sasisë së nevojshme të sasisë së ujit që nevojitet për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen si në shtresën e stabilizantit ,çakëllit . Në preventiv janë shtresa stabilizanti t = 20 cm: 2410 m<sup>2</sup>,

### **Ekskavator 2m<sup>3</sup> (copë 1)**

Për shpërndarjen e materialit të shtresave si në mbushje me çakëll e gur gurore 950 m<sup>3</sup>,

### **Grejder (copë 1)**

Për shpërndarjen dhe nivelimin e materialit të nënshtresave. Në preventiv janë shtresa stabilizanti  $t = 20 \text{ cm}$ :  $2410 \text{ m}^2$ ,

### **Ekskavator me goma $0.25 \text{ m}^3$ (copë 2)**

Për gërmimin e materialeve si dhe , në preventiv janë  $1660 \text{ m}^3$  gërmim dheu me eskavator.

### **Autovinç deri $2.5 \text{ ton}$ (copë 1)**

Për spostimin e shtyllave elektrike, në preventive janë spostim shtyllash elektrike 8 copë, Për vendosjen e ndriçuesve smart dhe krah shtylla metalike, në preventiv janë FV ndricues Smart Led 100 :79 copë

### **Spërkatës Boje për vijëzime në rrugë (copë 1)**

Për realizimin e zërit: Vizime me bojë bikomponente me gjerësi  $15 \text{ cm}$   $5360 \text{ ml}$ , vizime me bojë bikomponente  $50 \text{ m}^2$ .

### **Autobetoniere (copë 3)**

Per transportin e betonit të marrë nga nyjet e prodhimit të betonit si dhe për të patur cilësi të betonit. Në preventiv kemi shtresë betoni C 16/20  $327 \text{ m}^3$ , mure butobetoni C 12/15  $250 \text{ m}^3$ ,

### **Vibrator (copë 1)**

Kërkohet për vibrimin e betonit. Në preventiv kemi, punime betoni në të cilën kërkohet vibrator. struktura të holla monolite betoni C 16/20 :  $23 \text{ m}^3$ ,

### **Kallëpe (min $70 \text{ m}^2$ )**

Në zërin e analizës për realizimin e punimeve të betonit. Në preventiv kemi mure butobetoni C 12/15:  $250 \text{ m}^3$ ,

### **Betoniere $0.5 \text{ m}^3$ (copë 1)**

Për realizime në sasi dhe detaje të vogla betoni, në preventiv kemi struktura të holla monolite betoni C 16/20 :  $23 \text{ m}^3$ ,

### **Fabrikë asfaltbetoni (copë 1)**

Prodhimi i asfaltbetonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. në bazë të preventivit janë shtresë binderi  $5 \text{ cm}$   $11650 \text{ m}^2$ , shtresë asfaltbetoni  $4 \text{ cm}$   $11650 \text{ m}^2$

### **Fabrikë betoni (copë 1)**

Prodhimi i betonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. Në preventiv kemi shtresë betoni C 16/20 327 m<sup>3</sup>, mure butobetoni C 12/15 250 m<sup>3</sup>,

### **Kamionçinë deri 3.5 ton (copë 2)**

Mjet që përdoret për transportin e materialeve të imëta sjelljen e tyre në objekt dhe transportin e materialeve të ndryshme brenda kantierit si: F V shtylla metalike për ndriçim, H=7m: 79, tuba plastmasi Ø 80: 2700m, tuba plastmasi Ø 40: 83m, kablllo fuqie, tabela rrugore 25 copë, tuba të brinjëzuar Ø 315 70 ml.

### **Instrument për punimet gjeodezike (copë 1)**

Pajisje për piketimin dhe kuotimin e shesheve dhe mureve.

**Shënim:** Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>1</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike”, sjellim ne vemendje se:

Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca8) gjatë fazes së ofertimit.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST.

Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jetë kusht skualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht skualifikimi.

---

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

***Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kesaj veprë sipas preventivit të hartuara nga projektuesi.*

*Kriteret për kualifikim për procedurën respektive janë hartuar dhe venë në dispozicion për njësinë e prokurimit nga Komisioni i hartimit të kriterëve për kualifikim, i ngritur me Urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor me Nr.08, datë 07/01/2026,*

*Projekti, Preventivi, Grafiku i punimeve, Specifikimet teknike, Relacioni teknik dhe janë sipas materialit i cili është publikuar sëbashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga specialistët e fushës, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Lushnjë, në përputhje me detyrat funksionale që ajo ushtron.*

***Shënim:*** Në zbatim të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet kur në DT, preventiv, specifikime teknike apo çdo dokument shoqëruar, është cituar ndonjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohet me fjalët “ose ekuivalent i tij/i saj”, pasi në çdo rast emërtimi është bërë për arsye orientimi dhe nuk ka efekt kufizues apo përjashtues.

*Kudo në Specifikimet Teknike ku janë përcaktuar Standarte ndërkombëtare, mund të paraqiten edhe standarde shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.*

*Në Specifikimet Teknike bashkëlidhur DST, në fjalitë ku është përmendur Standardi European UNI 2332 , ose i ngjashëm me të, mund të paraqitet edhe standardi SSH/UNI/EN mbi konformitetin e standardit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. )*

*Në Specifikimet Teknike bashkëlidhur DST, në fjalitë ku janë përmendur standartet : “ ISO 4012,ISO 1920,ISO 7030,ISO 6275,BS 8110” ose të ngjashëm me këto,mund të paraqiten edhe standarde kombëtare SSH/ISO/BS mbi konformitetin e standardeve europiane, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.”*

- Fondi limit për këtë prokurim është përlogaritur mbështetur në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”
- Udhëzimin nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- Kodet e profesionit janë bazuar në vendimin nr.514, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar.
- Kërkohet prezenca e stafit teknik për realizimin e punimeve pa përcaktuar marrëdhëniet juridike të punësimit gjithashtu mënyra se si sigurohen këto makineri(pronësi, qera apo aktmarrëveshje furnizimi) nuk është përgjegjësi e këtij komisioni.

#### **NJËSIA E PROKURIMIT:**